Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Br. 01-020/01-0041156/26
Data 30.09.2026

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opstine/Municipal Assambly

Kuvendi i Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e rregullt të datës 29.09.2026, nxjerrë këtë:

DEKLARATË
"JO NË EMRIN TIM"

Kuvendi i Komunës së Skenderajt, duke respektuar pavarësinë e gjyqësorit, shpreh mospajtimin e tij të thellë me aktgjykimin e shkallës së parë të Dhomave të Specializuara të Kosovës, të datës 16 shtator 2026, ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Presidentit Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Kuvendi Komunal rithekson se lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte vazhdimësi e luftës për liri dhe çlirim, e lindur nga rrethanat e rënda të represionit, dhunës, vrasjeve dhe dëbimit të popullsisë shqiptare të Kosovës.

Kuvendi Komunal i Skenderajt shpreh solidaritetin e plotë me familjet e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, si dhe me të gjithë ata që këtë proces e kanë përjetuar me dhimbje dhe shqetësim.

Kuvendi u bën thirrje qytetarëve të Skenderajt dhe të gjithë Kosovës që, pavarësisht dhimbjes dhe emocioneve të forta, të ruajnë qetësinë, dinjitetin dhe unitetin, duke shprehur qëndrimet e tyre në mënyrë paqësore, demokratike dhe institucionale.

Duke pasur parasysh se vendimi është shpallur me formulimin "Në emër të popullit të Kosovës", Kuvendi Komunal i Skenderajt përcjell qartë mesazhin e qytetarëve të saj:

"JO NË EMRIN TIM!"

Ky qëndrim shpreh mospajtimin me dënimin e shqiptuar dhe të drejtën e qytetarëve për të kërkuar drejtësi dhe trajtim të drejtë për ish-krerët e UÇK-së:

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi.

Skenderaj
29.09.2026

Kryesuesja e Kuvendit
Adelina Spahiu Alija